



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 07 Shkurt 2022

Nr: 14

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË FLETËS SË VOTIMIT PËR ZGJEDHJET E
PJESHME PËR KRYETAR NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË,
RROGOZHINË DHE LUSHNJË, QË DO TË ZHVILLOHEN MË DATË 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit nr. 13 438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 20 pika 1, shkronja “g”, nenit 97, pika 2 dhe nenit 98, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator

V E N D O S I:

1. Miratimin e specifikimeve teknike të fletës së votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, sipas lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

Ilirjana NANO -	Kryetare
Arens ÇELA -	Anëtar
Dritan ÇAKA -	Anëtar
Helga VUKAJ -	Anëtare
Muharrem ÇAKAJ -	Anëtar



Lidhja 1

Specifikimet e fletës së votimit

Për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 06 Mars 2022

Lloji i letrës:

Watermark 90gr/m,² 100% pulp, me fibra karboni ultraviolet, 2 shtresa, me certifikate origjine, i vazhdueshëm me skicë speciale, me mikroprintime, element në printim që shikohet me rreze ultraviolet.

Zarfi me elementët e sigurisë dorëzohet i vulosur nga kompania prodhuese dhe depozitohet në KQZ.

Dimensionet e fletës së votimit:

Gjerësia e fletës së votimit 210 mm

Gjatësia e fletës së votimit 297 mm

Specifikime të përgjithshme:

Stema e Republikës, me ngjyra, dimensione: 18 mm x 20 mm

Logo KQZ, me ngjyra, dimensione: 20 mm x 20 mm

QR kodi (elemente teknik në formën e kodeve):

- Numri serial 6 shifra
- Bashkia 2 shifra
- Zona e Administrimit Zgjedhor 2 shifra
- Numri i Qendrës së Votimit 5 shifra

